



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I NDËRTIMTARISË – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, ndertesha e "Fakultetit Teknik", 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383-38-548 644

URL: <http://www.fna.uni-pr.edu>

Mail: fn@uni-pr.edu

Ref. nr. 2232/A Prishtinë 28.06.2022

PUBLIKIMI I ABSTRAKTIT TË PUNIMIT TË DIPLOMËS MASTER

DEPARTAMENTI INFRASTRUKTURË RRUGORE

Studenti **Valdete Morina** ka dorëzuar dorëshkrimin e punimit të diplomës Master me titull: “ **Menaxhimi i projekteve infrastrukturorenë nivelin lokal, rasti studimor Komuna Malishevë** ” në programin e studimeve Master Hidroteknik dhe dorëshkrimi është në procedurë të vlerësimit përfundimtar deri në vendimin e këshillit të Fakultetit të Ndërtimtarisë. Sipas rregullores për studimet Master Shkencor të Universitetit të Prishtinës, abstrakti i shkurtër i punimit të diplomës bëhet publik për periudhën kohore prej pesë ditësh nga dita e shpalljes.

Materiali i paraqitur në këtë punim ofron njohuri teorike dhe praktike mbi menaxhimin e projekteve inxhinierike. Projektet janë mënyrë e veçantë e zhvillimit (Gittinger, 1982) dhe formë e rëndësishme për realizimin e qëllimeve të definuara në planet zhvillimore të vendit, lokalitetit, kompanisë apo formës konkrete.

Projektet në ditët e sotme përbëjnë një instrument të rëndësishëm zhvillimor të përdorur masivisht, si nga sektori publik (Niveli qendror dhe ai lokal) edhe nga organizatat private. Ato janë gjithashtu një prej rrugëve kryesore të destinimit të fondeve të Komunitetit Evropian dhe organizatave ndërkombëtare për ndihmën drejt vendeve të pazhvilluara dhe atyre në zhvillim me synim të përmirësimit të infrastrukturës.

Menaxhimi i një projekti mund të duket si një detyrë e papërballueshme, e cila kërkon shumë përvojë, njohuri dhe praktikë pune. Shpesh kjo detyrë mund të duket e vështirë për t'u kuptuar ndjekur dhe plotësuar me sukses. Në jetën e përditshme, në një mënyrë apo në një tjetër, çdo njeri është, gjatë gjithë kohës, menaxher projektësh. Shpesh projekt-idetë ndërtohen në bazë të nevojave, mungesës së burimeve apo rreth problemeve ekzistuese, pa u përqendruar në hollësitë e tyre. Një menaxhim i mirë ngërthen në vete menaxhimin e mirë me shpenzimet e resurseve financiare dhe menaxhimin e kohës, elemente këto mjaftë të rëndësishme në tërë veprimtarinë e subjektit, e veçanërisht në realizimin e projektit të caktuar.

Menaxhimi i projektit është një aktivitet kompleks që kërkon strukturë, procedura dhe procese të cilat janë të përshtatshme për projektin. Kjo do të ju mundësojë për të menaxhuar ndryshimet e pashmangshme që ndodhin gjatë gjithë jetëgjatësisë së projektit, në mënyrë profesionale që të sigurohet suksesi. Çdo funksion i projektit përshkruan ekspertizën, aftësitë dhe mjetet e nevojshme për projektin.

Ky material synon të japë njohuri mbi konceptin e projektit në përgjithësi dhe projekteve inxhinierike që realizohen nga institucionet publike lokale në veçanti, dimensionet e projektit, menaxherin e projektit dhe rolin e tij, karakteristikat e projektit, fazat e ciklit të projektit, hartimin e tij, menaxhimin e kohës, koston por edhe të performancës së projektit, menaxhimin e riskut, vlerësimin e treguesve financiarë të projektit dhe sfidat në implementimin e projektit. Në material janë bërë përpjekje që konceptet, ilustrimet, si dhe pjesë të tjera të jenë sa më të përshtatshme dhe të vlefshme.

Dorëshkrimi i punimit është i atashuar në sekretarinë e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe është i qasshëm për publikun. Çdo vërejtje, plotësim, ndryshim mund të deponohet me shkrim i protokolluar dhe do të merret për trajtim nga këshilli i Fakultetit të Ndërtimtarisë.